



MANUAL

HARTIMI I PROGRAMEVE TE STUDIMIT DHE NDRYSHIMI I PROGRAMEVE EKZISTUES

Tabela e përmbajtjes

Hyrje	3
Krijimi i një programi/ programeve të reja	3
Riorganizimi i një program ekzistues deri në masën 20%	4
Hartimi i planit mësimor	5
Përlllogaritja e shpërndarjes së krediteve sipas veprimtarive mësimore	6
<i>Llogaritja e orëve të praktikës dhe proves finale</i>	8
<i>Orët e konsultimeve</i>	9
Shtojcë 1: Analizë e tregut të punës	12
Shtojcë 2: Kërkesa e njësisë bazë për hapjen e një program të ri studimi	13
Shtojcë 3: Modeli i planit mësimor.	14
Shtojca 4 Dokumentacionet në rast aplikimi për nje program të përbashkët studimi	15
Shtojca 5: Relacion i njësisë bazë për riorganizimin e programit të studimit	16
Shtojca 6: Modeli i programit të lëndës	17

Hyrje

Krijimi i programeve mësimore (kurrikulave) të reja dhe përditësimi e zhvillimi i programeve (kurrikulave) ekzistuese bëhet bazuar në ligjin Nr. 80/15, datë 22.07.2015 “Për arsimin elartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikëne Shqipërisë”, në Udhëzimin Nr. 1, datë 14.01.2020 të Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe në VKM Nr.41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë" ndryshuar me VKM Nr 879, datë 18.12.2019 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë"” si dhe në Memon e rektorit nr4/18 2018-08-25 “Për llogaritjen e krediteve dhe shpërndarjes së kohës mësimore në SHLUJ UMB”¹

Për hartimin e këtij Manuali janë marrë në konsideratë edhe standardet e sigurimit të cilësisë në vend, standardet europiane të sigurimit të cilësisë dhe Manuali i Komisionit European për sistemin e krediteve²

Krijimi i programeve të reja dhe ose riorganizimi i atyre ekzistuese bëhet duke respektuar parimet e mëposhtme:

- Program i ri apo i riorganizuar të jetë në përputhje me misionin e Universitetit “Barleti” (më tej UB) dhe planin aktual të zhvillimit strategjik të institucionit;
- Ai të jetë në përputhje me fushën e kualifikimit të njësisë bazë dhe kryesore;
- Programi të respektojë parimet e organizimit të kurrikulës të miratuara në legjislacionin në fuqi dhe në aktet rregulluese të UB;
- Të marrë në konsideratë kurrikulat ekzistuese në UB jo vetëm në lidhje me lëndët e kurrikulës CORE të përbashkët për të gjithë programet bachelor në UB, por edhe lëndët e modulet që ofrohen për ti përfshirë në listen e lëndëve me zgjedhje nga studentët;
- Të jetë në përputhje me kërkesat e tregut të punës;
- Te jete diskutuar gjerësisht me aktorët e interesit, studentët, pedagogët dhe specialistë të fushës dhe bordet e tregut të punës;
- Të jetë në përputhje me formën e programeve mësimore të ofruar aktualisht në UB;

Krijimi i një programi/programeve të reja

Propozimin për krijimin e një programi të ri e e bën njësia/njesite bazë akademike përgjegjese për ofrimin e programit, pas një analize të detajuar të tregut të punës. Në analizën e tregut të punës argumentohen arsyet e nevojës për hapjen e këtij programi studimi. (forma e analizës së tregut të punës të jetë sipas shtojcës së Udhëzimit Nr. 1, janar 2020³). Pjesë e analizës është edhe mundësia e ofrimit të këtij programi nga njësia bazë, përputhja me fushën e ekspertizës së njësisë bazë dhe të asaj kryesore, kapacitetet akademike dhe nevojat e institucionit.

¹ https://drive.google.com/file/d/1wMmN4E3wGNHsp3gVsk_9x1z3RhDK45NC/view

² (2015) <https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/da7467e6-8450-11e5-b8b7-01aa75ed71a1>
(2009) https://ec.europa.eu/education/ects/users-guide/docs/year-2009/ects-users-guide-2009_en.pdf

³ Udhëzimi Nr 1, datë 14.01.2020 gjendet elektronikisht në <http://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2020/01/Udhezimi-nr.-1-dt.-14.01.2020.pdf>.

Propozimi miratohet nga Dekani i Fakultetit dhe dërgohet për diskutim e miratim në Senatin Akademik. Pas miratimit në Senat, fillon puna për hartimin e programit (apo programeve) të ri që do të ofrohet.

Formatet dhe shtojcat:

- Shtojca 1: Analizës së tregut të punës
- Shtojca 2: Kërkesa e njësisë bazë për hapjen e programit të ri
- Shtojca 3: Modeli i planit mësimor
- Shtojca 4: Ofrimi i programeve të përbashkëta

Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë orienton, mbështet dhe konsulton procesin e hartimit të programit të ri të studimit dhe certifikon formën përfundimtare të tij.

Hapat e procesit të aplikimit për hapjen e një programi të ri dhe dokumentacioni që duhet të dorëzohet janë specifikuar në udhëzimin Nr. 1 datë 14.01.2020 të Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Riorganizimi i një program ekzistues deri në masën 20%

Për riorganizimin e programit të studimit deri në masën 20% (referuar ky ndryshim numrit të krediteve) njësia bazë argumenton nevojën për ndryshimin e programit dhe paraqet planin mësimor të ri, me propozimet e bëra për ndryshim për miratim tek Dekani. Dekani aprovon kërkesën e njësisë bazë dhe e dërgon për miratim në Senat.

Programi nuk mund të riorganizohet pa u akredituar asnjëherë, sipas specifikimeve të bëra në ligjin për arsimin e lartë. Si rregull i brendshëm, ndryshimet e tilla profilizuese të programit të studimit mund të bëhen vetëm një here nga njëri akreditim në tjetrin, por mund të ketë opt-out (përrjashtime) të justifikuar. Akreditimi është një proces me rëndësi dhe ndihmon fuqishëm për marrjen e vendimeve për të bërë ndryshime profilizuese të programit të studimit, për disa arsye:

Së pari, vlerësimi i jashtëm i programit të studimit nga ekspertë dhe rekomandimet e bëra prej tyre, mund të nxjerrin në pah nevojën për përmirësime të programit të studimit;

Së dyti, vlerësimi i brendshëm tërësor i programit të studimit, gjithashtu nxjerr në pah pikat e forta dhe të dobëta të programit të studimit;

Së treti, akreditimi i programit realizohet pas ofrimit, për një periudhë të caktuar kohe, kur mësimdhënia është konsoliduar, rezultatet e studentëve kanë dalë disa herë dhe nevojat për përmirësim janë më të bazuara.

Njësia bazë dhe kryesore, mbështetur në informacionet e mbledhura mund të kërkojë ndryshim pas një cikli të plotë të programit të studimit: në fund të tre viteve për programet bachelor, në fund të vitit për programet

master profesional me 60 ECTS, në fund të dy viteve për programet master me 120 ECTS, pas akreditimit të tyre dhe si rregull vetëm njëherë nga një akreditim në tjetrin.

Kërkesa për riorganizim parashtrohet nga njësia bazë dhe aprovohet nga Dekani dhe miratohet nga Senati Akademik.

Dokumentacioni për ndryshimin e planit mësimor deri në masën 20% është si vijon:

- plani i ri mësimor,
- plani i vjetër mësimor,
- relacioni për ndryshimin e programit nga njësia bazë
- miratimi i për ndryshimin nga Dekani
- Vendimi i Senatit për miratimin përfundimtar.

I gjithë dokumentacioni përgatitet nga grupi i punës që ka punuar për hartimin e programit. Materiali dërgohet për njoftim në MASR, e cila konfirmon ndryshimin e planit mësimor. Ndryshimi duhet të jetë i miratuar të paktën 6 muaj përpara fillimit të vitit të ri akademik. Përgjegjesinë për dërgimin e materialit në ministri e ka Njësia e Zhvillimit të Kurrikulës dhe Zyra e Protokollit.

Formatet dhe shtojcat

- Shtojca 4: Model relacioni e njësisë bazë për riorganizim program deri në 20%

Njësia e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë mbështet dhe konsulton procesin e riorganizimit të Programeve të reja të studimit.

Hartimi i planit mësimor

Plani mësimor hartohet nga njësia bazë që do të ofrojë programin e studimit, pasi është orientuar dhe konsultuar me Njësien e Zhvillimit të Kurrikulës dhe Cilësisë. Draft plani vlerësohet nga Njësia përpara se të dërgohet për miratim tek Dekani i Fakultetit dhe në Senat.

Krijimi i planit mësimor apo riorganizimi i planit ekzistues, bëhet duke mbajtur në konsideratë objektivat e formimit të studentëve dhe zërthehet në kompetenca kryesore që janë të nevojshme për formimin e tyre profesional. Hapi i parë është përcaktimi i lëndëve dhe pesha e tyre në kredite. Shpërndarja e lëndëve sipas komponentëve mësimorë është e përcaktuar në VKM Nr.41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë" ndryshuar me VKM Nr 879, datë 18.12.2019 "Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 41" Në tabelën e mëposhtme paraqiten përmbledhtas.

Komponenti mësimor	Niveli 5	Niveli 6	Niveli 7		
	Program profesional	BA	MP	MSH	MSH (PI)
A LËNDË BAZË- përgatitje metodologjike dhe	10-15%	15-20%	5-10%	5-10%	15-20%



	kulturë e përgjithshme					
B	LËNDË KARAKTERIZUESE- përgatitje për disiplinën	45-55%	50-55%	30-40%	50-60%	45-55%
C	LËNDË NDËRDISIPLINORE/ INTEGRUESE- nëndisiplina, profile dhe grup lëndë me zgjedhje	5-15%	12-15%	20-30%	12-20%	12-15%
D	LËNDË PLOTËSUESE- gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale	10-15%	10-15%	10%	10%	6-8%
E	DETYRIME PËRMBYLLËSE	3-5%	3-5%	10-20%	10-15%	3-5%

*A+B jo më pak se 70% në programet Bachelor dhe në programet e integruara dhe jo më pak se 60% në programet Master i Shkencave

Përlllogaritja e shpërndarjes së krediteve sipas veprimtarive formuese (mësimore)⁴

Llogaritja e krediteve të disiplinave mësimore, sipas veprimtarive formuese, të programeve të studimit në UniBa, duhet të zhvillohet sipas skemës dhe shpjegimeve si vijon.

Raporte të mundëshme të veprimtarive formuese brenda një disipline (lënde):

Leksione	50 – 85% e krediteve	Seminare/Ushtrime	15 – 33% e krediteve
Laboratore	15 – 33% e krediteve	Projekt-detyra	8 – 17% e krediteve

Numri i javëve mësimore në dispozicion: 15 javë/semestër, 30 javë/viti.
Numri i orëve totale për kredit: 25

	Orë në auditor	Orë studimi individual
Numri i orëve për kredit leksione	6 – 12	(19 – 13)
Numri i orëve për kredit seminare	6 - 8	(19 – 17)
Numri i orëve për kredit ushtrime	12 – 18	(13 – 7)
Numri i orëve për kredit laboratore	18 – 25	(7 – 0)
Numri i orëve për kredit praktika	20 – 25	(5 – 0)
Numri i orëve për kredit projekt-detyra	1 – 2	(24 – 23)

Shpërndarja e krediteve sipas veprimtarive formuese bëhet në mënyrë të atillë, që të krijojë hapësirën e nevojshme për realizimin e vlerësimit formues. Vlerësimi formues ose vlerësimi i vazhduar, krijon mundësi për të vendosur studentin në qendër, duke rritur peshën e aktiviteteve apo detyrave që studenti zhvillon në mënyrë të pavarur, gjatë semestrit dhe duke ulur peshën e vlerësimit përfundimtar.


Kjo realizohet nëpërmjet dy komponentëve:

(1) me anën e peshës së diferencuar në ECTS të projekteve detyrave;

⁴ <https://www.unideusto.org/tuningeu/workload-a-ects/177-educational-structures-learning-outcomes-workload-and-the-calculation-of-ects-credits.html#Overall>

(2) duke shtuar orët e konsultimeve javore me pedagogun, në varësi të numrit të krediteve, shpjeguar më poshtë.

Përlllogaritja e krediteve për çdo veprimtari formuese mësimore, bëhet sipas një kornize orientuese të shpërndarjes së peshës së lëndës në leksione dhe veprimtari të tjera formuese. Modeli i pasqyruar më poshtë është modeli udhëzues për shpërndarjen e balancuar mes veprimtarive mësimore në auditor dhe jashtë tij. Njësitë bazë dhe kryesore janë ato që vendosin nëse do të ruhet kjo shpërndarje apo do të ketë një ndryshim në përqindjet e secilës kategori.



50% të krediteve leksione. Ky është një rregull i përgjithshëm për të gjithë programet në UB. Për çdo program studimi dhe për çdo lëndë, pesha e krediteve për orë leksionesh është 50%. Për 1ECTS leksione, 10 orë në auditor dhe 15 orë studim individual.

33% e krediteve seminare/ushtime/laboratorë. Në varësi të lëndës/modulit bëhet edhe shpërndarja e krediteve për secilën veprimtari. Në rastet e lëndëve teorike, 33% e krediteve caktohen orë seminaresh. Por në varësi të objektivave të lëndës dhe kompetencave që duhet të arrijnë studentët, njësia bazë përcakton ndarjen mes tre komponentëve. Llogaritja e orëve për kredite, në UB, bëhet si më poshtë:

- 1 kredit = 7 orë seminare dhe 18 orë studim individual
- 1 kredit = 12 orë ushtime dhe 13 orë studim individual
- 1 kredit = 18 orë laboratorë dhe 7 orë studim individual

17% e krediteve projekte detyra kursi.

Bëjnë përjashtim nga ky rregull

- lëndët/ modulet laboratorike,
- lëndët/ modulet sportive
- lëndët/ modulet teknike në programe si arkitektura apo teknologjia e informacionit.

Në këto raste, është njësia bazë që përcakton numrin e orëve laboratorike dhe nëse ka nevojë për veprimtari të tjera, në bazë të objektivave të lëndës dhe kompetencave që duhet të arrijnë studentët, duke ruajtur raportet orë për kredit dhe orë studim individual.

Raportet e orëve për kredite, për rubrikat përkatëse për të cilat flitet, janë përzgjedhur brenda intervaleve të rekomanduara zyrtarisht në dokumentet e sipërcituara, në varësi të natyrës së përgjithëshme të trajtimit dhe sistemimit të veprimtarive formuese në Universitetin “Barleti”.

Modeli nr. 1

Moduli	ECTS	100%	50%	33% e ECTS	17% e ECTS	orë
--------	------	------	-----	------------	------------	-----

	Gjithsej (kredite)	Gjithsej (orë)	ECTS				Projekte/Detyra Kursi 1 -2 orë/ECTS	studimi individual
			Leksione 10 orë /ECTS	Seminare 7 orë/ECTS	Laboratorë 18 /ECTS	Ushtrime 12orë/ECTS		
moduli 1	1	7	5	2			0.2	18
moduli 2	2	15	10	5			0.3	35
moduli 3	3	22	15	7			0.5	53
moduli 4	4	30	20	9			0.7	70
moduli 5	5	37	25	12			0.9	88
moduli 6	6	45	30	14			1.0	105
moduli 7	7	52	35	16			1.2	123
moduli 8	8	60	40	18			1.4	140
moduli 9	9	67	45	21			1.5	158
moduli 10	10	75	50	23			1.7	175
moduli 11	6	45	30	14			1.0	105

Më poshtë një model (modeli nr.2) tjetër për shpërndarjen e 33% kredite në seminare, ushtrime dhe laboratorë. Ky është një model për të ilustruar shpërndarjen e orëve. Është njësia bazë në bashkëpunim me pedagogun e lëndës që vendosin për mënyrën se si mund të shpërndahen sa më mire komponentët mësimorë në mënyrë që të arrihen objektivat e lëndës dhe të lehtësojë formësimin e kompetencave profesionale tek studentët.

Modeli nr. 2

Moduli	ECTS	100%	50%	33% e ECTS			17% e ECTS	orë studimi individual
	Gjithsej (kredite)	Gjithsej (orë)	Leksione 10 orë /ECTS	13% Seminare 7 orë/ECTS	10% Laboratorë 18 orë /ECTS	10% Ushtrime 12orë/ECTS	Projekte/Detyra Kursi 1 -2 orë/ECTS	
moduli 1	1	9	5	1	2	1	0.2	16
moduli 2	2	21	10	5	4	2	0.3	29
moduli 3	3	31	15	7	5	4	0.5	44
moduli 4	4	42	20	9	7	5	0.7	58
moduli 5	5	52	25	12	9	6	0.9	73
moduli 6	6	63	30	14	11	7	1.0	87
moduli 7	7	73	35	16	13	8	1.2	102
moduli 8	8	84	40	18	14	10	1.4	116
moduli 9	9	94	45	21	16	11	1.5	131
moduli 10	10	105	50	23	18	12	1.7	145

Llogaritja e orëve të praktikës dhe provës finale

Pesha krediteve për praktikë profesionale janë të përcaktuara në VKM Nr.41, datë 24.01.2018.

- Për praktikën profesionale për 1 kredit, në UB llogariten 22.5 orë praktikë në institucion dhe 2.5 orë studim individual.

Për detyrimet përmbyllëse, tezë apo provim final, në UB llogariten 3.5 orë për kredit për orë konsultimi në auditor dhe 21.5 orë për kredit studim dhe përgatitje individuale.

Orët e konsultimeve

Duke qenë se në organizimin e programeve mësimore në UB i jepet prioritet punës së pavarur të studentit, për ta mbështetur më tej këtë proces studentët mbështeten edhe nëpërmjet orëve javore të konsultimit. Në varësi të numrit të krediteve llogariten dhe orët e konsultimit javore për secilën lëndë.

Orët e konsultimit janë orë në të cilën studentët mund të konsultohen me pedagogun/en çdo javë. Konsultimi mund të jetë një diskutim në grup apo edhe individual mbi një çështje të caktuar, komunikim me email me studentët lidhur me detyrat dhe projektet që po zhvillohen apo mbështetje për projekte e detyra zhvilluese.

Nëpërmjet orëve të konsultimit, studentët kanë mundësi të marrin vëmendje të diferencuar sipas nevojave dhe kanë mundësi të marrin këshillim të individualizuar lidhur me zhvillimin e tyre profesional e akademik. Orari dhe rregullat e konsultimit përcaktohen në programin e lëndës nga vetë pedagogu i lëndës. Llogaritja e orëve të konsultimit bëhet bazuar në peshën e krediteve që ka lënda sipas tabelës së mëposhtme.

	Gjithsej	Leksione	Seminare/ ushtrime/ laboratorë	Projekte detyra	Orë konsultimi në javë	Orë konsultimi gjithsej
ECTS	3	1.5	1	1	0.6	9
orë në klasë	23	15	7	1		
orë individuale	53	22.5	18	12		
raporti orë individuale/orë në auditor në mesatare	2.3	1.5	2.6	24		
ECTS	4	2	1	1	0.8	12
orë në klasë	30	20	10	1		
orë individuale	71	30	24	16		
raporti orë individuale/ore në auditor në mesatare	2.3	1.5	2.6	24		
ECTS	5	2.5	2	1	1	15
orë në klasë	38	25	12	1		
orë individuale	89	37.5	31	20		
raporti ore individuale/orë në auditor ne mesatare	2.3	1.5	2.6	24		



ECTS	6	3	2	1		
orë në klasë	45	30	14	1		
orë individuale	105	45	36	24	1.2	18
raporti ore individuale/orë në auditor në mesatare	2.3	1.5	2.6	24		
ECTS	7	3.5	2	1		
orë në klasë	52	35	16	1		
orë individuale	123	52.5	42	29	1.4	21
raporti orë individuale/orë në auditor në mesatare	2.3	1.5	2.6	24		
ECTS	8	4	3	1		
orë në klase	60	40	18	1		
orë individuale	140	60	48	33	1.6	24
raporti orë individuale/orë në auditor në mesatare	2.3	1.5	2.6	24		
ECTS	9	4.5	3	2		
orë në klase	67	45	21	2		
orë individuale	158	67.5	53	37	1.8	27
raporti orë individuale/orë në auditor në mesatare	2.3	1.5	2.6	24		
ECTS	10	5	3	2		
orë ne klasë	75	50	23	2		
orë individuale	175	75	59	41	2	30
raporti orë individuale/orë në auditor në mesatare	2.3	1.5	2.6	24		

Modeli i programit të lëndës

Modeli i programit të lëndës është i përcaktuar me vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.41, datë 24.01.2018. Bashkëlidhur këtij manuli, *shtojca 6*, gjendet modeli i programit të lëndës i përshtatur për UB.

Në programin e lëndës përcaktohen qartësisht objektivat e lëndës/modulit dhe temat dhe aktivitetet mësimore që do të realizohen për arrijen e tyre dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të studentëve. Në program duhet të reflektohen aktivitetet mësimore që justifikojnë ngarkesën e orëve mësimore caktuar në planin mësimor. Në rastin kur kemi 1 kredit detyra/projekte, pedagogu parashikon një orë shpjegim në klasë dhe udhëzime të shkruara në programin e lëndës dhe 24 orë punë individuale. Pedagogu duhet të parashikojë që detyra apo projekti që studenti do të realizojë, kërkon mesatarisht 24 orë mësimore për tu realizuar. Në këto 24 orë parashikohen



orët që studenti hulumton, shkruan dhe përgatit prezantimin e detyrës. E njëjta logjikë duhet të ndiqet për çdo veprimtari tjetër mësimore. Tabela e mësipërme detajon peshën specifike për çdo komponent mësimor për module me kredite të ndryshme, të shpërndara sipas raporteve të propozuara 50% leksione, 33% seminare dhe 17% projekte detyra kursi.

Shtojcë 1: Analizë e tregut të punës

Ky seksion artikulon mënyrën se si programi i propozuar i përgjigjet nevojave të tregut të punës, duke përfshirë kërkesën aktuale dhe të parashikuar të tregut të punës për të diplomuarit e programit.

Analiza e tregut të punës duhet të përmbushë tre objektivat e mëposhtëm:

1. Të identifikojë se si programi i propozuar rrit aftësitë/ mundësitë/ potencialin e studentëve për të përfituar aftësi/njohuri që përputhen me kërkesat e tregut të punës me qëllim punësimin e qendrueshëm me të ardhura sa më të larta.
2. Të identifikojë se si programi i propozuar përmbush kërkesat e punëdhënësve, për forcën e punës në një periudhë afatmesme.
3. Të identifikojë se si programi i propozuar përshtatet me ose përmbush politikat kombëtare të punësimit dhe zhvillimit.
4. Duhet parashikuar që, në analizë të përshihen elementët e mëposhtëm:
 - (1) citime të plota për burimet e përdorura
 - (2) referenca në tekst për burimet e përdorura;
 - (3) adresat e burimeve online.

Në këtë seksion duhet të përfshihen të dhëna mbi elementët e mëposhtëm:

- ndryshimi dhe avantazhet potenciale të programit të propozuar për hapje/riorganizim, në lidhje me programet e ngjashme të studimit të ofruara nga IAL të tjera.
- Trendi vendas dhe rajonal i punësimit në sektorin ku bën pjesë programi i studimit, referuar burimeve zyrtare si INSTAT, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, organizma ndërkombëtare, etj.
- Strukturat në dispozicion të studentëve, për të bërë ndërlidhjen me tregun e punës si dhe burimet financiare në dispozicion të këtyre strukturave.
- Punësimi potencial i studentëve.
- Marrveshje/kërkesa paraprake nga operatorë privatë/institucione publike për punësimin eventual të studentëve pas diplomimit.

Shtojcë 2: Kërkesa e njësisë bazë për hapjen e një program të ri studimi

Tiranë, më

Lënda: Propozim për hapjen e programit të ri të studimit “Bachelor në”

Drejtuar: Dekan i Fakultetit të

Për të hartuar relacionin njësia bazë duhet përgjigjur pyetjeve orientuese të mëposhtme:

1. Si ka lindur nevoja për hapjen e këtij programi?
2. Çfarë risie do të sjellë ky program i ri mësimor në ofertën akademike të Departamentit?
3. A është konsultuar programi i propozuar me aktorët dhe bashkëpunëtorët (stafi, studentët, profesionistë të fushës, bordin e tregut të punës)?
4. A është, ky program, në përputhje me aktet ligjore në fuqi?
5. Si do e mbështesë njësinë bazë ky program studimi në ofertë, nevoja, burime etj. Cilat janë lëndët që do të ndryshojnë? (plotësohet tabela e mëposhtme).
6. A ka konsultuar grupi i punës Njësinë e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë mbi këtë proces?

Propozimi është sipas formatit zyrtar të dokumentacionit në UB me logo dhe firmë.

Dokumenti firmoset nga drejtuesi/ ja e departamentit



Shtojcë 3: Modeli i planit mësimor⁵.



FAKULTETI I EKONOMISË, QEVERISJES DHE DREJTËSISË

MIRATOHET

DEKANE

Prof. Asoc. Dr. Zamira Çavo

REKTOR

Prof. Dr. Marenglen Spiro

PLANI MËSIMOR

Programi i Studimit BACHELOR në: DREJTËSI
(Me kohë të Plotë)

Tiranë, 2020

Plani mësimor: Bachelor në Drejtësi (viti I)																												
Nr.	Lënda	Moduli	Kodi i Lëndës	Tipi i Veprimtarisë	Ngarkesa Totale në Orë								Ngarkesa Javore në Orë						Orë Individuale									
					Gjithësej (kredite)	Gjithësej (orë)	Leksione	Seminare	Laboratore / Ushtrime	Projekte / Dejra Kursi	Praktikë	Provë Finale	Semestri 1			Semestri 2												
													Leksione	Seminare / projekte	Laboratore / ushtrime	Praktikë	Provë finale	Provime		Leksione	Seminare / projekte	Laboratore / ushtrime	Praktikë	Provë finale	Provime			
1	Elementët e së Drejtës Publike	Elementët e së Drejtës Publike	DPB 013	A	6	45	30	14		1					2	1							x				105	
2	Sociologji	Sociologji	SOC 011	A	6	45	30	14		1					2	1											105	
3	Mendimi Ekonomik	Mendimi Ekonomik	MEK 016	A	6	45	30	14		1					2	1											105	
4	Teknologji Informacioni	Teknologji Informacioni	INF 015	A	6	45	30	14		1					1	0.5						1	0.5				x	105
5	Gjuhë Angleze	Gjuhë Angleze	ANG 014	C	6	45	30	14		1					1	0.5						1	0.5				x	105
6	Historia e së Drejtës	Historia e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri	HSD 402	C	6	45	30	14		1												2	1.0				x	105
		Historia e Institucioneve Politiko-Juridike	HIP 402	C	4	30	20	9		1													1.3	0.7				x
7	Mendimi Juridik	Filozofia e së Drejtës	FDR 402	A	4	30	20	9		1												1.3	0.7				x	70
		E Drejta Romake	EDR 401	B	4	30	20	9		1												1.3	0.7				x	70
8	E drejta kushtetuese shqiptare dhe e krahasuar	E Drejta Kushtetuese	EDK 401	B	6	45	30	14		1												2	1				x	105
9	Metodat e Kërkimit Shkencor dhe Shkrim Akademik	Metodat e Kërkimit Shkencor dhe Shkrim Akademik	MKA 012	C	6	45	30	14		1												2	1				x	105
Gjithësej					60	449	300	139		10					8	+						12	6				##	##
										Orë në javë					12					18								

Shtojca 4: Dokumentacionet në rast aplikimi për një program të përbashkët studimi

- Burimeve financiare
- Kontributi i partnerëve
- Vënia në dispozicion e burimeve nga partnerët
- Administrimi i programit
- Lëshimi i diplomës dhe lloji (*diplomë e përbashkët/ e dyfishtë/ shumfishtë*)
- Të dhëna mbi aktin e themelimit/ licencimit të institucionit partner në vendin e origjinës
- Të dhëna mbi aktin e akreditimit të institucionit partner ose të programit të studimit
- Dokument zyrtar bashkëpunimi mes palëve, marrëveshja kuadër
- Marrëveshja specifike për programin konkret të studimit

Shtojca 5: Relacion i njësisë bazë për riorganizimin e programit të studimit

Tiranë, më

Lënda: Propozim për ndryshim në masën 20% në planin mësimor “Bachelor në”

Drejtuar: Dekanit të Fakultetit të

Për të hartuar relacionin njësia bazë duhet përgjigjet pyetjeve orientuese të mëposhtme:

1. Si ka lindur nevoja për rishikimin e programit ekzistues?
2. Çfarë risie do të sjellin këto ndryshime në programin mësimor?
3. A janë konsultuar ndryshimet e propozuara me aktorët dhe bashkëpunëtorët (stafi, studentët, profesionistë të fushës, bordin e tregut të punës)
4. A rrit ky ndryshim mundësitë për integrimin dhe zhvillimin profesional të studentëve?
5. Si e argumenton njësia bazë që ndryshimi e programit është nën masën 20% në kredite?
6. A janë ndryshimet e bëra në përputhje me aktet ligjore në fuqi, lidhur me hartimin e programeve të studimeve?
7. Si do e ndikojë njësia bazë ky program studimi në ofertë, nevoja, burime etj.
Cilat janë lëndët që do të ndryshojnë? (plotësohet tabela e mëposhtme).
8. A ka konsultuar grupi i punës Njësinë e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë mbi këtë process ?

SI ËSHTË NË PLANIN MËSIMOR				SI PRITET TË NDRYSHOHET			
Emri lënda/ moduli	kredite	viti	semestri	Emri lënda/ moduli	kredite	viti	semestri
1							
2							
3							
4							

Propozimi është sipas formatit zyrtar të dokumentacionit në UB me logo dhe firmë.

Dokumenti firmoset nga drejtuesi/ ja e departamentit

Shtojca 6: Modeli i programit të lëndës

PROGRAMI I LËNDËS

(Kodi - Emri i lëndës (modulit))

Shënim: Të gjitha shënimet brenda kllapave, me të pjerrëta, duhet të fshihen, përfshirë këtë shënim.

Titullari⁶ / pedagogu i lëndës: (emri, titulli akademik, grada shkencore, dhe nënshkrimi)

Ngarkesa: (numri i krediteve ECTS, numri i orëve mësimore, leksion dhe seminar, praktika, etj.)

Viti akademik/semestri kur zhvillohet:

Kategoria⁷: (Sipas referencës)

Lloji i lëndës: (e detyrueshme ose me zgjedhje)

Programi i studimit: (programi për të cilin ofrohet kjo lëndë)

Adresa elektronike e titullarit/pedagogut të lëndës:

Kodi i Etikës: Studentët janë të detyruar të njihen dhe të zbatojnë parimet etiketëpërcaktuaranë Kodin e Etikës të Universitetit Barleti.

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

A. Përmbledhja: (Përmbledhja është një abstrakt që jep idenë e përgjithshme të kursit dhe njohuritë kryesore që do të marrë studenti).

B. Rezultatet e të nxënit: (Bashkësi e dijeve, aftësive e kompetencave specifike të fushës, që studenti duhet të fitojë në përfundim të lëndës).

- a.
- b.
- c.
- d.
- e.

⁶Titullari është personel akademik i kategorisë 'Profesor', ose ka gradën Doktor, në mungesë të personelit të kategorisë 'Profesor'. Titullari firmos në syllabus, përpara pedagogut të lëndës/modulit, për lëndë të përafërta brenda një fushe të ngjashme studimi, të cilat organizohen në grup-lëndë.

Pedagogu i lëndës, është personel akademik i cili do të zhvillojë lëndën. Pedagogu mund të jetë i kategorisë Profesor, Lektor ose Asistent - lektor.

⁷ Kategoria A-D referuar planit mësimor:

A - Lëndëbazë– përgatitjemetodologjikedhekulturëpërgjithshme.

B - Lëndëkarakterizuese– përgatitjepërdisiplinëshkencore.

C - Lëndëndërdisiplinore/integruese– nëndisiplina,profiledhegrup-lëndëmezgjedhje.

D - Lëndëplotësuese– gjuhëtëhuaja,njohuriinformatike,praktikaprofesionale.

E - Detyrimepërmbyllëse.

KONCEPTET THEMELORE: (janë konceptebazë mbi të cilat ndërtohet lënda, rekomandohet të përcaktohen 5-10 koncepte)

1.
2.
3.
4.
5.

JAVA	TEMAT E LËNDËS (shpjegimi (rreth një paragraf) i çdo teme të leksionit sipas javëve, shoqëruar me literaturën përkatëse (të detajuar me faqe).	Literatura (Referimi sipas stilit APA)
I	<p>Tema: (Përshkrimi)</p> <p><u>Metoda pedagogjike për seminarin/laboratorin</u> (Përshkrimipërmënyrën e zhvillimit të seminarit – ushtrime, raste studimore, prezantime, punënë grup, etj.)</p>	Teksti 1 ⁸ , fq. x-x.
II	<p>Tema: (Përshkrimi)</p> <p><u>Metoda pedagogjike për seminarin/laboratorin</u> (Përshkrimi për mënyrën e zhvillimit të seminarit – ushtrime, raste studimore, prezantime, punënë grup, etj.)</p>	Teksti 1, fq. x-x.
III	<p>Tema: (Përshkrimi)</p> <p><u>Metoda pedagogjike për seminarin/laboratorin</u> (Përshkrimi për mënyrën e zhvillimit të seminarit – ushtrime, raste studimore, prezantime, punënë grup, etj.)</p>	Teksti 1, fq. x-x.
IV	<p>Tema: (Përshkrimi)</p> <p><u>Metoda pedagogjike për seminarin/laboratorin</u> (Përshkrimi për mënyrën e zhvillimit të seminarit – ushtrime, raste studimore, prezantime, punënë grup, etj.)</p>	Teksti 1, fq. x-x.
V	<p>Tema: (Përshkrimi)</p> <p><u>Metoda pedagogjike për seminarin/laboratorin</u> (Përshkrimi për mënyrën e zhvillimit të seminarit – ushtrime, raste studimore, prezantime, punënë grup, etj.)</p>	Teksti 1, fq. x-x.

⁸ Numri i literaturës (Teksti)i referohet listimit në kategorinë e literaturës bazë të detyrueshme.

<p>VI</p>	<p>Tema: (Përshkrimi) <u>Metoda pedagogjike për seminarin/laboratorin</u> (Përshkrimi për mënyrën e zhvillimit të seminarit – ushtrime, raste studimore, prezantime, punënë grup, etj.)</p>	<p>Teksti 1, fq. x-x.</p>
<p>VII</p>	<p>Tema: (Përshkrimi) <u>Metoda pedagogjike për seminarin/laboratorin</u> (Përshkrimi për mënyrën e zhvillimit të seminarit – ushtrime, raste studimore, prezantime, punënë grup, etj.)</p>	<p>Teksti 1, fq. x-x.</p>
<p>VIII</p>	<p>Tema: (Përshkrimi) <u>Metoda pedagogjike për seminarin/laboratorin</u> (Përshkrimi për mënyrën e zhvillimit të seminarit – ushtrime, raste studimore, prezantime, punënë grup, etj.)</p>	<p>Teksti 1, fq. x-x.</p>
<p>IX</p>	<p>Tema: (Përshkrimi) <u>Metoda pedagogjike për seminarin/laboratorin</u> (Përshkrimi për mënyrën e zhvillimit të seminarit – ushtrime, raste studimore, prezantime, punënë grup, etj.)</p>	<p>Teksti 1, fq. x-x.</p>
<p>X</p>	<p>Tema: (Përshkrimi) <u>Metoda pedagogjike për seminarin/laboratorin</u> (Përshkrimi për mënyrën e zhvillimit të seminarit – ushtrime, raste studimore, prezantime, punënë grup, etj.)</p>	<p>Teksti 1, fq. x-x.</p>
<p>XI</p>	<p>Tema: (Përshkrimi) <u>Metoda pedagogjike për seminarin/laboratorin</u> (Përshkrimi për mënyrën e zhvillimit të seminarit – ushtrime, raste studimore, prezantime, punënë grup, etj.)</p>	<p>Teksti 1, fq. x-x.</p>
<p>XII</p>	<p>Tema: (Përshkrimi)</p>	<p>Teksti 1, fq. x-x.</p>



	<p><u>Metoda pedagogjike për seminarin/laboratorin</u> (Përshkrimi për mënyrën e zhvillimit të seminarit – ushtrime, raste studimore, prezantime, punënë grup, etj.)</p>	
XIII	<p>Tema: (Përshkrimi) <u>Metoda pedagogjike për seminarin/laboratorin</u> (Përshkrimi për mënyrën e zhvillimit të seminarit – ushtrime, raste studimore, prezantime, punënë grup, etj.)</p>	Teksti 1, fq. x-x.
XIV	<p>Tema: (Përshkrimi) <u>Metoda pedagogjike për seminarin/laboratorin</u> (Përshkrimi për mënyrën e zhvillimit të seminarit – ushtrime, raste studimore, prezantime, punënë grup, etj.)</p>	Teksti 1, fq. x-x.
XV	<p>Tema: (Përshkrimi) <u>Metoda pedagogjike për seminarin/laboratorin</u> (Përshkrimi për mënyrën e zhvillimit të seminarit – ushtrime, raste studimore, prezantime, punënë grup, etj.)</p>	Teksti 1, fq. x-x.

FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE**FREKUENTIMI:**

Studenti duhet të frekuentojë të paktën 50% të seancave të leksioneve dhe 75% të seancave të ushtrimeve (dhe/ose seminareve/laboratorëve/praktikave). Për detajet, referencë është Rregullorja e Universitetit.

KONTROLI I VAZHDUESHËM:

Komponentët e vlerësimit (Modeli I)	Pesha (%)
Provimi i ndërmjetëm	20
Pjesëmarrja dhe aktivizimi	10
Detyra e kursit ⁹	20
Provimi përfundimtar ¹⁰	50
TOTALI	100

Tabela e Vlerësimit

Përqindja <i>p</i> (%)	$0 \leq p < 50$	$50 \leq p < 56$	$56 \leq p < 66$	$66 \leq p < 76$	$76 \leq p < 86$	$86 \leq p < 96$	$96 \leq p \leq 100$
Nota	4	5	6	7	8	9	10

LITERATURA: (Literaturaparaqet listën e botimeve (referuar sipas stilit APA) që studenti duhet të lexojë gjatë lëndës, e ndarë në)

a) Literatura bazë e detyrueshme:

(Mbiemër, E. (Viti). Titulli. Qyteti: Shtëpia botuese.)

b) Literatura e rekomanduar:

(Mbiemër, E. (Viti). Titulli. Qyteti: Shtëpia botuese.)

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS (Hapësira ku pedagogu parashtron mendime, rekomandime, vërejtje, kufizime, rezerva që lidhen me zhvillimin e lëndës në fjalë gjatë vitit akademik, nëse ka)

⁹ Detyra e kursit mund të jetë: ese, punë në grup, rast studimor, projekt, prezantim, performancë sportive ose artistike, etj. Ajo përcaktohet nga titullari, në varësi të specifikave të lëndës.

Periudha e zhvillimit të provimit të ndërmjetëm, dhe periudha e zhvillimit dhe/ose dorëzimit të detyrës së kursit, vendosen në javën/të përkatëse në syllabus. Provimi i ndërmjetëm, në varësi të specifikave të lëndës/modulit, zhvillohet në javën e gjashtë ose të shtatë, dhe kontrollon njohuritë e temave të zhvilluara në pesë javët e para. Provimi i ndërmjetëm zhvillohet në orën e seminarit/praktikës së javës përkatëse.

¹⁰ Zhvillimi i provimit përfundimtar është i detyrueshëm, pavarësisht sasisë së pikëve të grumbulluara nga komponentët e tjerë të vlerësimit.



Studenti nuk lejohet:

1. të çënojnë dinjitetin dhe integritetin e studentëve të tjerë, stafit akademik dhe administrativ.
2. të çënojnë mbarëvajtjen e procesit akademik.
3. të kopjojnë në provime apo në punën e dikujt tjetër.
4. të fabrikojnë të dhëna.
5. të përdorin pajisjet teknologjike për aktivitete që nuk lidhen me zhvillimin e orës mësimore.

Përgatitur nga NJKZHC

Miratuar për përdorim të brendshëm nga Rektori